

Lënda: Mbi vendimin e refuzimit të informacionit të kërkuar dhe kufizimit të së drejtës të informimit.

Z. E. GJ.

Për dijeni:

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 14.11.2023, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në adresën elektronike info@dap.gov.al, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, kërkonti sërish informacion në lidhje me nëpunësin më të vjetër në shërbimin civil, në Sektorin e Monitorimit të Rrjetit Antikorrupsion, në Drejtorinë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë, ju bëjmë me dije se:

DAP i është përgjigjur kërkesës tuaj me të njëjtin objekt, të datës 02.11.2023, brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar. Më konkretisht, me emailin e datës 14.11.2023 kemi sqaruar se DAP administron Regjistrin Qendror të Personelit, por bazuar në pikën 3, të kreut II, të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", është njësia e burimeve njerëzore në çdo institucion e cila përgjigjet për mbajtjen, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar.

Për më tepër, në kreun III dhe IV të VKM-së së sipërcituar në lidhje me Regjistrin Qendror të Personelit përcaktohet se:

"1. RQP-ja, si bazë unike të dhënash shtetërore, përmban të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore.

2. Të dhënat parësore që reflektohen në RQP, janë:

a) të dhëna që lidhen me institucionin;

b) të dhëna që lidhen me të punësuarit.

4. Të dhënat parësore që lidhen me të punësuarit, sipas shkronjës "b", të pikës 2, të këtij kreu, janë:

a) përmbajtja e dosjes së personelit;

b) të dhënat për marrëdhëniet e punës në vite (libreza e punës)"

3. Institucionet e administratës shtetërore kanë detyrimin të hedhin e të përditësojnë në RQP:

- a) të dhënat parësore të përcaktuara në pikën 4, të kreut III, të këtij vendimi;**
- b) informacionin e nevojshëm për llogaritjen e pagës mujore;
- c) informacionet financiare të nevojshme për automatizimin e pagës mujore”

Nga ana tjetër, në pikën 1 dhe 12, të nenit 3, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. “Të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

12. “Përpunim i të dhënave personale” është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

Në vijim, në nenin 6, të këtij ligji, përcaktohet se:

“Kriteret ligjore për përpunimin

1. Të dhënat personale përpunohen vetëm:

a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;

b) nëse përpunimi është thelbësor për përmbushjen e një kontrate, për të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese, apo për diskutime ose ndryshime të një projekti/kontrateme propozimin e subjektit të të dhënave;

c) për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave;

ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;

d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;

dh) nëse është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të kontrolluesit, marrësit apo personave të tjerë të interesuar. Por, në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private.

Për më tepër, vetë Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Zyra e Komisionerit), në një rast tjetër, me shkresën nr. 1395/1 prot., datë 05.08.2022, drejtuar DAP-it, ndër të tjera, thekson se: “...Përhapja e të dhënave personale konsiderohet përpunim dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, **“Të dhënat personale përpunohen vetëm: a)**

nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin; ...ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit...

Të dhënat e kërkuara nga ana juaj janë të dhëna personale dhe duke qënë se institucioni përgjegjës për mbajtjen, administrimin/përditësimin dhe përpunimin e të dhënave që ju kërkoni është Ministria e Drejtësisë, në rastin në fjalë, DAP nuk mund të justifikojë përpunimin e këtyre të dhënave, brenda kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 6, të sipërcituar, në mënyrë që të mund t'i jepet një përgjigje kërkesës tuaj.

Theksojmë se, të drejtat dhe detyrimet e të gjithë përdoruesve të Regjistrisë Qendrore të Personelit, përfshirë këtu dhe DAP-in, përcaktohen në mënyrë shteruese në Vendimin nr. 833, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave dhe si rrjedhojë DAP nuk mund të tejkalojë të drejtat dhe kompetencat, që janë përcaktuar në këtë VKM, sidomos për sa i përket përpunimit të të dhënave personale.

Bazuar në gjurmën "a", të pikës 1, të nenit 17, të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:*
a) të drejtën për një jetë private...", DAP vlerëson se, përpunimi i pautorizuar dhe i pajustificuar i të dhënave personale, do cënonte të drejtën për një jetë private të subjekteve të këtyre të dhënave. Për sa më sipër, çmojmë se jemi përpara rastit të kufizimit të së drejtës së informimit dhe për këto arsye kemi vendosur refuzimin e dhënies së informacionit të kërkuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

